



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 18.01.2023

Drejtorja e Administratës

Shërbimi për Kuvend dhe Komitete

RAPORTI I PUNËS PËR FUNKSIONIMIN E KUVENDIT TË
KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS PËR PERUDHËN
JANAR/DHJETOR 2022

Janar 2023

Përmbajtja e raportit.....	2
Hyrja.....	3
Struktura e raportit.....	3
Qëllimi i raportit.....	3
Puna, aktivitetet dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe	
Kuvendit të Komunës.....	4
Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës.....	4
Konkluzionet dhe Rekomandimet.....	11

Hyrje

Raporti i Punës për Funksionimin dhe aktivitetet e Kuvendit të Komunës, Komitetit për Politikë e Financa, për periudhën Janar/Dhjetor të vitit 2022 është i bazuar në dispozitat dhe detyrimet që dalin për Legjislastivin e Komunës, si organi më i lartë i Komunës nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjet Sektoriale, Udhëzimet Administrative, Statuti i Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013, për realizimin e punëve dhe detyrat e punës së Legjislativit të Komunës.

Kuvendi i Komunës, mbështetur në kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, ka miratuar: Kornizën Afatmesme Buxhetore, Buxhetin e Komunës, Raportin Përfundimtar Vjetor Financiar dhe Raportin Financiar gjashtëmujor.

Struktura e raportit

Raporti i Punës së Kuvendit të Komunës synon të bëjë një vlerësim për progresin e arritur në përmbushjen e obligimeve ligjore, zbatimin e punëve dhe aktiviteteve, mbështetur në kompetencat e bazuara me ligj si dhe nivelin e përmbushjes së përgjegjësiave që lidhen me realizimin e kërkesave të ekzekutivit si dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve të komunës.

Struktura e raportit përfshin:

- Funksionimin e Kuvendit të Komunës;
- Funksionimin e Komitetit për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete;
- Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës;
- Konkluzionet dhe rekomandimet.

Raporti përfshin periudhën Janar/Dhjetor 2022. Raporti bazohet në të dhënat e mbledhura nga ekstraktet e procesverbaleve dhe aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës. Raporti shërben për nxjerrjen e një pasqyre dhe konkluzioneve më të hollësishme për funksionimin e Kuvendit të Komunës dhe hapave të cilët duhet të ndërmerren për përmirësime në të ardhmen.

Qëllimi i raportit

Raporti ka për qëllim informimin e drejtë dhe objektiv të qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit, për mënyrën e funksionimit të Kuvendit të Komunës dhe mekanizmave tjerë përcjellës. Raporti pasqyron punën dhe aktivitetet e të zgjedhurve në mbrojtjen e interesave të qytetarëve si dhe shërben si mjet adekuat për rritjen e transparencës së organit më të lartë të komunës, i cili i ka dy funksione kryesore: 1. Funksionin vendimmarrës në shpërndarjen e buxhetit dhe 2. Funksionin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të shpenzimeve.

Puna, aktivitetet dhe mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës

1. Komiteti për Politikë e Financa, si trup profesional i Kuvendit të Komunës, ka për detyrë shqyrtimin e politikave komunale dhe orientimeve strategjike të Komunës, shqyrtimin e aktiviteteve financiare të Komunës, Planin Vjetor të prokurimit publik, Planin Vjetor të auditimit të brendshëm dhe çështje tjera për të cilat jep rekomandime dhe nxjerr përfundime e konkluzione profesionale se si të veprohet në orientimin e politikave programore për zhvillimin ekonomik lokal, rregullimin hapësinor dhe territorial, zhvillimin, rregullimin dhe strukturimin e administratës, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, infrastrukturës, mjedisit, bujqësisë, e fushave tjera.
2. Komiteti për Komunitete, si trup profesional i Kuvendit të Komunës, është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Po ashtu, gjatë punës së tij, Komiteti për Komunitete, jep rekomandime për Kuvendin e Komunës lidhur me buxhetin, politikat programore për zhvillimin ekonomik lokal, zhvillimin e administratës, arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit, infrastrukturës, mjedisit, bujqësisë, e fushave tjera.
3. Kuvendi i Komunës, si organ më lartë i Komunës dhe organ përfaqësues për subjektet politike, të cilat i përfaqësojnë qytetarët e Komunës dhe e kanë për obligim t'i mbrojnë interesat e tyre. Kuvendi i Komunës, bazuar në kompetencat e tij, propozimet e Ekzekutivit të Komunës, rekomandimet e dy Komiteteve të Përhershme: Komiteti për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete, merr vendime për buxhetin dhe çështje tjera financiare, miraton aktet normative nga fusha e veprimtarisë së institucioneve lokale të pushtetit, miraton planet zhvillimore dhe rregullative, bën emërtimin e rrugëve e shesheve në territorin e Komunës dhe vendosë për shumë çështje tjera me interes lokal.
4. Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës ka themeluar edhe pesë Komitete tjera funksionale si vijon: Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti për Planifikim Urban, Infrastrukturë dhe Shërbime Publike, Komiteti për Persona me Nevoja të Vecanta dhe Komiteti për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra.

Aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës

Mbledhja inauguruese është mbajtur me datë 03.12.2021, ku e kanë dhënë betimin anëtarët e Kuvendit të Komunës, gjithsej 27 anëtar dhe betimi i Kryetarit të Komunës.

1. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 1049, të datës 24.11.2021, për zgjedhjen e z. Ali Ismaili i lindur me datën 21.03.1980, me vendbanim në Fushë-Kosovë, me profesion historian, në pozitën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2021-2025.
2. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 1050, të datës 24.11.2021, për emërimin e z. Bashkim Krasniqi i lindur me datën 03.04.1980, me vendbanim në Fushë-Kosovës, përfaqësues nga Inicitiva për Fushë-Kosovën e Egjiptianëve dhe Ashkalinjëve, në pozitën

e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për Komunitete, në Komunën e Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2021-2025.

3. Komiteti për Politikë dhe Financa

- 1.1 Ali Ismaili - përfaqësues nga Partia e Drejtësisë, Kryesues i Komitetit;
- 1.2 Remzi Shala - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
- 1.3 Mirlina Krasniqi - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
- 1.4 Miranda Shabani - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
- 1.5 Durim Hajra - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
- 1.6 Eglantina Azemi - përfaqësuese nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtare;
- 1.7 Mirsad Qyqalla - përfaqësues nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar.

4. Komiteti për Komunitete

- 1.1 Jetmir Berisha - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
- 1.2 Arjeta Jashari - përfaqësuese nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtare;
- 1.3 Shpend Bardiqi - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
- 1.4 Dardane Sogojeva Shala - përfaqësuese nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtare;
- 1.5 Artan Asllani - përfaqësues i komunitetit ashkalinjë nga Lista Ndryshe, anëtar;
- 1.6 Radoman Doderovic - përfaqësues i komunitetit serb nga Iniciativa Qytetare Serbe, anëtar;
- 1.7 Linda Hyseni - përfaqësuese e komunitetit egjiptian, anëtare;
- 1.8 Fehmi Gashi - përfaqësues i komunitetit romë, anëtar;
- 1.9 Milica Filipovic - përfaqësuese e komunitetit malazez, anëtar.

Komitetet e Përshërshme të Kuvendit të Komunës

- 1. Komiteti për Politikë e Financa ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje.
- 2. Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 8 mbledhje.

Kuvendi i Komunës për kryerjen e përgjegjësiave në sektor të caktuar me vendim ka themeluar:

- 1. Komiteti për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport, ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje;
- 2. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje;
- 3. Komiteti për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike, ka mbajtur gjithsej 1 mbledhje;
- 4. Komiteti për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra, ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje;
- 5. Komiteti për Persona me Nevoja të Vecanta, ka mbajtur gjithsej 3 mbledhje.

Kuvendi i Komunës ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, prej tyre 11 të rregullta, një mbledhje të jashtëzakonshme, një mbledhje solemne, janë marrë gjithsej 85 vendime.

Lista e vendimeve janar - dhjetor 2022

Janar 2022

1. Vendim për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2021, në vitin fiskal 2022 në shumë të përgjithshme prej 5,007,507.41€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 38, të datës 20.01.2022.
 - Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 504,445.52€;
 - Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 508,768.69€;
 - Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 3,994,293.20€.
2. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 22, të datës 20.01.2022 për fillimin e procedurave për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale 'Fushë-Kosovës' dhe lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 10,000.00€, kapital fillestar për Ndërmarrjen Publike Lokale.
 - Detyrat dhe përgjegjësitë e Ndërmarrjes Publike Lokale 'Fushë-Kosova' janë si vijon: mirëmbajtja e investimeve publike të komunës, parkut rekreativ në fshatin Sllatinë e Vogël, parqeve dhe hapësirave të vogla publike në qytet, hapësirave publike nëpër oborre të objekteve shkollore dhe objekteve shëndetësore në qytet dhe nëpër fshatrat tona, palestrave dhe fushave të sportit, hyrjeve dhe daljeve të njësive banesore në ndërtesa, parkingjet dhe tregun.
3. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 23 të datës 20.01.2022, për themelimin e tre Drejtorive të Komunës së Fushë-Kosovës si vijon: Drejtoria e Infrastrukturës Lokale, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Teknologji Inovacion dhe Integritet Evropian.
 - Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorive të reja të komunës do të inkorporohen në ndryshim-plotësimin e Rregullores për Organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të 25.09.2014.
4. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 24, të datës 20.01.2022 për emërimin e z. Suhat Ademi i lindur më datë 24.02.1975 me vendbanim në Fushë-Kosovë, përfaqësues nga Iniciativa e Fushë-Kosovës për Egjiptian dhe Ashkali, në pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete në Komunën e Fushë-Kosovës në mandatin zgjedhor 2021-2025.
5. Vendim për zgjedhjen e anëtarëve të Komisioneve për rekrutimin e Drejtorëve të Shkollave në Komunën e Fushë-Kosovës.
 - Për konkursin e Shkollës së Mesme të Lartë 'Hivzi Sulejmani' në Fushë-Kosovë përzgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
Miranda Sulejmani - Kryetare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
Sabri Xhigoli - anëtar i Komisionit, drejtor në Shollën Filllore të mesme të Ulët 'Daut Bogujevci' në Fushë-Kosovë;

- Arian Mustafa - anëtar i Komisionit, nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Albert Kurtulaj - në cilësinë e vëzhguesit dhe
- Besnik Musa - në cilësinë e vëzhguesit.
- Për konkursin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë përzgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
Salih Jashanica - Kryetar i Komisionit, drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Zenel Salihu' në Bardh të Madh;
 - Miranda Sylejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 - Arian Mustafa - anëtar i Komisionit, nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.
 - Gazmend Bekolli - në cilësinë e vëzhguesit;
 - Krenare Azizi - në cilësinë e vëzhgueses.
 - Për Konkursin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Vëllezërit Frashëri' në Miradi të Poshtme përzgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
Gëzim Berisha - Kryetar i Komisionit, drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Laura Scotti' në Graboc të Poshtëm.
 - Miranda Sylejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese nga Drejtoria Komunale e Arsimit;
 - Arian Mustafa - anëtar i Komisionit, nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit.
 - Fisnik Sllamniku - në cilësinë e vëzhguesit;
 - Mirsad Drenovci - në cilësinë e vëzhguesit.
6. Vendim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Planit të Veprimit për Transparencë dhe Projekt-Rregullores për Transparencë, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
- Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës,
 - Vjollca Konjusha - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - Vlonjat Hasani - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar;
 - Migjen Kolshi - Përfaqësuesi i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - Hasan Ismajli - Përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
 - Ali Topalli - Zyrtar për Informim, anëtar;
 - Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - Bardhyl Kojçiçi - Shef për Planifikimin e Buxhetit, anëtar;
 - Lindita Dervisholli Prebreza - Zyrtare e Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe barazi Gjinore, anëtar;
 - Sllaxhana Laziç - Shefe e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtare dhe
 - Maliq Thaçi - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.
7. Vendim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për organizimin bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
- Remzi Shala - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;

- Krenar Dumani - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - Durim Hajra - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar;
 - Mirsad Qyqalla - Përfaqësues i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - Bashkim Krasniqi - Përfaqësuesi i Iniciativës së Fushë-Kosovës për Egjiptian dhe Ashkali, anëtar;
 - Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - Ardit Sekiraqa - Zyrtar për Ndërtimtari dhe Mbikëqyrje, anëtar;
 - Bekim Rexha - Zyrtar për Regjistrim të Adresave, anëtar;
 - Besare Sllamniku - Zyrtare për Menaxhim Financiar dhe Kontroll, anëtare
 - Ejup Qyqalla - Shef për Shërbime Publike, anëtar;
 - Rrahmon Stollaku - Përfaqësues i Shoqërisë Civile, anëtar.
8. Vendim për aprovimin e Propozimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, për përfaqësim në Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës, për mandatin zgjedhor 2021-2025.
- Komunën e Fushë-Kosovës për Kuvendin e Përgjithshëm të Asociacionit të Komunave të Republikës së Kosovës do ta përfaqësojnë:
- Burim Berisha - Kryetar i Komunës;
 - Mirlinda Krasniqi - Përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës;
 - Habib Mekolli - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje.

Shkurt 2022

1. Vendim për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2021, në vitin fiskal 2022 në shumë të përgjithshme prej 5,007,507.41€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 121, të datës 16.02.2022.
2. Vendim për themelimin e Komitetit për Arsim Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: pesë (5) anëtarëve si vijon:
 - Jahush Krasniqi - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - Vlonjat Hasani - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - Migjen Kolshi - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - Shemsije Fetahu - anëtare dhe
 - Fitore Simnica - anëtare.
3. Vendim për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: pesë (5) anëtarëve si vijon:
 - Laureat Gojnovci - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - Hasime Kostanica - përfaqësuese e Kuvendit të Komunës nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtare
 - Aida Alimi - përfaqësuese e Kuvendit të Komunës nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtare
 - Mustafë Gashi - anëtar dhe

Albulena Zeqiri - anëtare.

4. Vendim për themelimin e Komitetit për Persona me Nevoja të Veçanta në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: pesë (5) anëtarëve si vijon:
Etnik Berjani - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
Driton Ademi - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Nisma Socialdemokrate, anëtar;
Qëndresa Ademi - përfaqësuese e Kuvendit të Komunës nga Iniciativa e Fushë-Kosovës për Ashkali dhe Egjiptian, anëtare
Maliq Thaqi - anëtar dhe
Diellëza Strumcaku - anëtare.
5. Vendim për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës me dokumentacion personal të identifikimit, për vitin 2022 në shumë mjeteve financiare prej 245.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
6. Vendim për miratimin e Propozimit Nr. 25, të datës 11.02.2022 për vazhdimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2022 si vijon:
 - Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej: 1.55€ për një metër katror në kategorinë e parë;
 - Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej: 2.10€ për një metër katror në kategorinë e dytë;
 - Taksa administrative për leje të rrënit në shumë prej: 0.95€ për një metër katror;
 - Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë në shumë prej: 4.84€ për kokë banori, një metër katror.
 - Miratimi i taksave administrative dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë për vitin 2022, mbështetet në shkresën - pëlqimin e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. 4318/20, të datës 14.12.2021.
7. Vendim për ndarjen e lokacionit për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për raste të veçanta, me numër të certifikatës së pronës P-72514036-00696-0, në Zonën Kadastrale në Fushë-Kosovë për ndërtimin e Statcionit të Policisë në Fushë-Kosovë.
8. Vendim për aprovimin në parim të Programit Trevjeçar të Banimit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2022-2024, si dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik.
 - Programi Trevjeçar i Banimit i Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2022-2024, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
9. Vendim për miratimin e Propozimit Nr. 54, të datës 25.02.2022 për bonuset e zonimit sipas Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 100, të datës 05.08.2020.
 - Mënyrat e kompensimit të tokës private të planifikuar për interes të përgjithshëm sipas Hartës Zonale të Fushë-Kosovës, të miratuar me vendim të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës Nr. 100, të datës 05.08.2020, të jetë aplikimi i koeficientit të ndërtimit edhe për sipërfaqen e kësaj toke.
10. Vendim për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', Aneksi II, në Komunën e Fushë-Kosovës.

- Për konkursin e Shkollës Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', Aneksi II, në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 Ismet Gashi - Kryetar i Komisionit drejtor në Shollën Fillore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë;
 Miranda Sulejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit.
 Nexhat Limoni - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 Faruk Foniqi - në cilësinë e vëzhguesit.
11. Vendim për formimin e shtatë Grupeve Punuese për hartimin e Projekt-Rregulloreve Komunale, në përbërje prej njëmbëdhjetë në secilin grup, me pesë anëtarë të Kuvendit të Komunës, pesë anëtarë drejtor dhe shërbyes civil nga Ekzekutivi i Komunës dhe Administrata e Komunës, si dhe me nga një anëtar të Shoqërisë Civile.

Mars 2022

1. Vendim për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: pesë (5) anëtarëve si vijon:
 - Fisnik Sllamniku - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - Leona Bërbatovci - përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - Habib Mekolli - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - Agnesa Breznica - anëtare dhe
 - Shemsi Kelmendi - anëtar.
2. Vendim për themelimin e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: pesë (5) anëtarëve si vijon:
 - Krenar Dumani - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - Hasan Ismajli - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, anëtare
 - Bashkim Krasniqi - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Iniciativa e Fushë-Kosovës për Ashkali dhe Egjiptian dhe Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, anëtar
 - Lirije Thaqi Xhigoli - anëtare dhe
 - Hava Avdullahu - anëtare.
3. Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 22, të datës 07.02.2022, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-144/5, të datës 24.02.2022 dhe Rekomandimeve të dalura nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, me Nr. 83, të datës 24.03.2022, lidhur me aprovimin e Propozimit Nr. 23 të datës 20.01.2022, për themelimin e tre Drejtorateve të reja të Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Vendim për aprovimin në parim të Propozimit Nr. 150, të datës 15.03.2022, për ndryshimplotësimin e Rregullores Nr. 125, të datës 25.09.2014, për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale dhe dërgimin e saj në procedurën e diskutimit publik.

- Me ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 125, të datës 25.09.2014, për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale, propozohet themelimi i tre Drejtorateve të reja të Komunës së Fushë-Kosovës.
5. Vendim për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës Drejtorit/es të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët ‘Selman Riza’ në Fushë-Kosovës.
- Për rekrutimin e kandidatëve për konkursin për Zëvendës Drejtor/e të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët ‘Selman Riza’ në Fushë-Kosovë për zgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - Miranda Sylejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 - Sadri Emini - Zëvendës drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët ‘Mihal Grameno’, aneksi i shkollës në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë;
 - Arian Mustafa - anëtar i Komisionit, nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit;
 - Krenare Azizi - në cilësinë e vëzhguesit;
 - Gazmend Bekolli - në cilësinë e vëzhguesit;
6. Vendim për formimin e ‘Komisionit për emërtimin, plotësimin-ndryshimin e emërimit të rrugëve dhe vendeve tjera publike’ në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej:
- Vjollca Konjusha - anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - Jahush Krasniqi - anëtar i Kuvendit, anëtar;
 - Shpend Bardiqi - anëtar i Kuvendit, anëtar;
 - Aida Alimi - anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - Qëndresa Ademi - anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - Samir Shahini - Drejtor për Arsim, anëtar;
 - Besnik Shala - Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport, anëtar;
 - Ejup Qyqalla - Shef i Shërbimeve Publike, anëtar;
 - Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban, anëtare;
 - Bekim Rexha - Zyrtar për Regjistrimin e Adresave, anëtar;
 - Xhevdet Qirriqi - Përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar.
7. Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të Komunës së Fushë-Kosovës për Statcionin e Policisë sipas rasteve të veçanta, me numër të certifikatës së pronës P-72514036-00696-0, në Zonën Kadastrale në Fushë-Kosovë, me destinim për ndërtimin e Statcionit të Policisë në Fushë-Kosovë.
- Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim bëhet për nëntëdhjetë e nëntë vite, për institucionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme - Statcionin e Policisë në komunën tonë.
 - Qëllimi i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, është ndërtimi i Statcionit të ri të Policisë në Komunën e Fushë-Kosovës.
8. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 239, të datës 15.03.2022, për lirin e bizneseve nga pagesa e taksës komunale për vitin 2022, për të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike dhe biznese në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.

9. Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për mandatin zgjedhor 2021-2025.

Prill 2022

1. Vendim për aprovimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës, për periudhën janar-dhjetor të vitit të 2021, në shumë të përgjithshme prej 11,330,647.54€.
Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,585,115.02€;
Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,759,884.89€;
Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,956,188.66€;
Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 29,458.97€.
2. Vendim për aprovimin e Propozimit për caktimin e lokacionit për vendosjen dhe ndërtimin, e shtatores së heroit Hysen Zogjani në rrugën 'Dëshmorët e Lirisë', në hapësirën 4x4 metra në njësinë kadastrale, të evidentuar në certifikatën e pronës Nr. P-72514036-00837-0 në Fushë-Kosovë.
3. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 356, të datës 15.04.2022, për faljen e borxheve të vjetëruara - obligimeve të krijuara nga taksat komunale për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, për të gjitha subjektet afariste të regjistruara në Komunën e Fushë-Kosovës, përkatësisht 1035 subjekte afariste, në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej: 782,408.00€ (shtatë qind e tetëdhjetë e dy mijë e katër qind e tetë euro), për periudhën kohore nga viti 2009 deri në vitin 2016.
4. Vendim për aprovimin e Propozimit për caktimin e lokacionit, për ndërtimin e Palestrës së Gjimnastikës në fshatin Miradi e Poshtme, në ngastrën kadastrale Nr. P-72514027-00196-1, psh. fshati në Zonën Kadastrale Miradi e Poshtme, sipas certifikatës së pronës të lëshuar me datën 05.05.2022, nga kadastri dhe specifikimin e grafikës për pronën në gjeodezi për lokacionin me Nr. P-72514027-00196.
Palestra e Gjimnastikës do të ndërtohet sipas 'Marrëveshjes ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës'.
5. Vendimi Nr. 58, i datës 07.03.2022, për bonuset e zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovë, mbetet në fuqi, pas rishqyrtimit të Kërkesës DL Nr. 1140-2/22, të datës 25.03.2022, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe shkresës përcjellëse të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. VI - 020 -239/13, të datës 25.03.2022.
Kuvendi i Komunës rekomandon që Ekzekutivi i Komunës, respektivisht Drejtoria e Planifikimit Urban, në kordinim dhe ndërlidhje të punës dhe veprimeve me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, të harmonizon kërkesat për rishqyrtim lidhur me bonuset e zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovë, sipas Kërkesës DL Nr. 1140-2/22, të datës 25.03.2022, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për hartimin e aktit të përgjithshëm, për bonuset e zonimit sipas legjislacionit në fuqi, për dokumentet e planifikimit hapësinorë.
6. Vendim për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorit të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', Aneksi II, në Komunën e Fushë-Kosovës.

- Për konkursin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', Aneksi II, në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 Ismet Gashi - Kryetar i Komisionit drejtor në Shollën Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë;
 Miranda Sulejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit.
 Nexhat Limoni - në cilësinë e vëzhguesit dhe
 Faruk Foniqi - në cilësinë e vëzhguesit.

Maj 2022

1. Vendim për aprovimin e Propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 23,000.00€, nga 'Kodi Bashkëfinancimi i Projekteve Nr. 44684', për ndërtimin e objektit publikë me karakterë shoqërorë në Ngastrën Kadastrale Nr. P - 72514031-00228-0, në fshatin Henc.
 - Në ndërtimin e objektit publikë me karakterë shoqërorë, do të participojnë edhe banorët e fshatit Henc.

Qershor 2022 qqqq

1. Vendim për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2023-2025, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2023 buxheti i komunës është në shumë prej: 15,093,935.00€;
 - 1.2 Për vitin 2024 buxheti i komunës është në shumë prej: 16,055,498.00€;
 - 1.3 Për vitin 2025 buxheti i komunës është në shumë prej: 16,669,975.00€.
2. Vendim për aprovimin e Kërkesës Nr. 634, të datës 28.06.2022, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 250,000.00€, për punësimin për kohë të caktuar të punëtorëve shëndetësorë e nëpunës administrativ dhe mbështetës, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi', në Fushë-Kosovë, për periudhën gjashtëmujore përmes procedurës së hapur të konkurimit publikë.

Paga për secilin të punësuar me kohë të caktuar, do të realizohet sipas pagesës së fundit, të pagës mujore në Projektin e Karitasit, me rritjen sipas vendimit Nr. 10, të datës 04.02.2021.

Numri dhe pozitat e punëtorëve shëndetësorë e nëpunës administrativ dhe mbështetës, për përmbushjen e nevojave të operimit dhe funksionimit të institucioneve shëndetësore në Komunën e Fushë-Kosovës është si vijon:

 - Dymbëdhjetë (12) mjekë familjarë;
 - Gjashtëmbëdhjetë (16) infermerë;
 - Dy (2) stomatologë;
 - Dy (2) teknikë të stomatologjisë;
 - Tre (3) teknikë të lobaratorit;
 - Një (1) teknikë të farmacisë;
 - Një (1) inxhinierë të teknologjisë informative;

Katër (4) vozitës;
Dy (2) hixhenistë dhe
Dy (2) roje për ndërrimin e natës.

3. Vendim për aprovimin e Kërkesës Nr. 610, të datës 22.06.2022, për lejin e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej: 315,000.00€ nga buxheti i komunës, për rritjen e shtatëdhjetë (70) normave të reja, për mësimdhënës e nëpunës administrativ dhe mbështetës për vitin shkollorë 2022-2023 dhe për pesëdhjetë e pesë (55) mësimdhënës e nëpunës administrativ dhe mbështetës, të punësuar në vitin shkollorë 2021-2022.
Shuma e mjeteve financiare të lejuara nga buxheti i komunës, në pikën një të vendimit, do të shfrytëzohen për pagesat e shtatëdhjetë (70) normave të reja për mësimdhënës e nëpunës administrativ dhe mbështetës prej viti shkollorë 2022-2023 dhe pesëdhjetë e pesë (55) mësimdhënës e nëpunës administrativ dhe mbështetës nga viti shkollorë 2021-2022, për periudhën gjashtëmujore shtator 2022 - shkurt 2023.
4. Vendim për aprovimin e Propozimit për caktimin e anëtarëve në Komisionin Komunal të Aksionarëve në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi', për mandatin zgjedhor 2021-2025, në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - Laureat Gojnovci - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - Habib Mekolli - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar dhe
 - Ekrem Berjani - përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës, anëtar.Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit Komunal të Aksionarëve, është veprimi në emër të Komunës së Fushë-Kosovës për mbrojtjen e interesave të qytetarëve të komunës tonë, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave 'Pastrimi', në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
5. Vendim për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për vitet 2023-2027.
6. Vendim për miratimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm për Fushë-Kosovën.

Korrik 2022

1. Vendim për lejin e mjeteve financiare për Klubin e Futbollit 'Fushë-Kosova', në shumë të përgjithëshme prej: 55,000.00€, me destinim për t'i ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në Kampionatin e Futbollit të Ligës së Parë të Kosovës për vitin garues 2022-2023, si vijon:
Shuma e lejuar e mjeteve financiare prej: 27,500.00€, në vitin buxhetor 2022, do të shërbejnë klubit të futbollit për mbulimin e shpenzimeve, në sezonin vjeshtorë të garave kampionale futbollistike dhe
Shuma e lejuar e mjeteve financiare prej: 27,500.00€, në vitin e ardhshëm buxhetor 2023, do të shërbejnë klubit të futbollit për mbulimin e shpenzimeve, për sezonin pranëverorë të garave kampionale futbollistike.
2. Vendim për lejin e mjeteve financiare për Klubin e Vollejbollit për Femra 'Fushë-Kosova', në shumë të përgjithëshme prej: 16,000.00€, me destinim për t'i ndihmuar në mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrjen në Kampionatin e Vollejbollit të Femrave, në Superligën e Vollejbollit të Kosovës për vitin garues 2022-2023, si vijon: Shuma e lejuar e mjeteve financiare prej: 8,000.00€, në vitin buxhetor 2022, do të shërbejnë klubit të volejbollit për femra për mbulimin e shpenzimeve, në sezonin vjeshtorë të garave

kampionale vollejbolistike dhe shuma e lejuar e mjeteve financiare prej: 8,000.00€, në vitin e ardhshëm buxhetor 2023, do të shërbejnë klubit të vollejbollit për femra për mbulimin e shpenzimeve, për sezonin pranëverorë të garave kampionale vollejbolistike.

3. Vendimi për aprovimin e propozimit për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për 'Rroga dhe paga'. Mjetet financiare, në shumë të përgjithshme prej 16,409.19€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimor, mbajtjen e provimeve nga mësimi joformal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Ekonomike 'Hoxhë Kadri Prishtina', kodi i programit Nr. 94232, shuma prej: 8,345.03€ dhe në arsim të mesëm për Shkollën e Mesme Teknike 'Minatori', kodi i programit Nr. 94231, shuma prej: 8,064.16€.
4. Vendim për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores Komunale për bonuese të zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovës. Projekt-Rregullorja Komunale për bonuese të zonimit për ndërtime në Fushë-Kosovës, e cetur në pikën një të këtij vendimi, cakton lejimin me stimulime në emër të kompenzimit të interesit publikë, për lirim të sipërfaqeve për objektet dhe infrastrukturën publike.
5. Vendim për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores Komunale për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakterë të përkohshëm, në pronat e personave fizikë dhe juridikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Projekt-Rregullorja Komunale për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakterë të përkohshëm, në pronat e personave fizikë dhe juridikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cetur në pikën një të këtij vendimi, parasheh vendosjen e objekteve me karakterë të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridikë. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Rregullorja Komunale për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakterë të përkohshëm, në pronat e personave fizikë dhe juridikë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
6. Vendim për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit të Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2023-2025, në Komunën e Fushë-Kosovës. Projekt-Planit i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2023-2025, në Komunën e Fushë-Kosovës, i cetur në pikën një të këtij vendimi, parasheh zbatimin nga institucionet komunale të programeve, punëve dhe aktiviteteve për barazi gjinore. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Projekt-Planit i Veprimit për Barazi Gjinore për vitet 2023-2025, në Komunën e Fushë-Kosovës.
7. Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 131, të datës 10.05.2022 dhe vendimit Nr. 58, të datës 07.03.2022
8. Vendim për plotësimin e pikës një të Vendimit Nr. 130, të datës 10.05.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës së Gjimnastikës, në ngastrën kadastrale me Nr. P-72514027-00196-4, me destinimin e saj 'Zonë e shërbimeve - institucion shkollorë' sipas Hartës Zonale të Komunës, në hapësirat afër shkollës për plotësimin e nevojave të shkollës dhe sportit, në sipërfaqe prej: $S=2783^2$, të evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 14-942-21485/N, të datës 03.08.2022, në vendin e quajtur 'Livade Pashnjak' në Zonën Kadastrale Miradi e Poshtme. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria e Gjeodezisë Kadastrit e Pronës, Drejtoria e Planifikimit Urban, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë e Sportit dhe është pjesë e vendimit Nr. 130, të datës 10.05.2022.

9. Vendim për plotësimin e pikës një të Vendimit Nr. 129, të datës 10.05.2022, për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores së heroit Hysen Zogjani, në rrugën 'Dëshmorët e Lirisë' në Fushë-Kosovë, në ngastrën kadastrale me Nr. P-72514036-00837-0, me destinimin e saj 'Park-Shesh' sipas Hartës Zonale të Komunës dhe 'Raportit teknik për rilevimin e terrenit në hapësirën 4x4 metra, me sipërfaqe $S=16m^2$, të datës 04.07.2022', në psh. rrugë e pakategorizuar në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, të evidentuar në certifikatën e pronës me datën 05.04.2022. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezisë Kadastrit e Pronës, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë e Sport dhe është pjesë e vendimit Nr. 129, të datës 10.05.2022.
10. Vendim për plotësimin e vendimit Nr. 176, të 16.12.2020 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Fushë-Kosovës.

Shtator 2022

1. Vendim për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023, në shumë të përgjithshme prej 15,093,936.00€, i shpërndarë nëpër programe e nënprograme të kategorive ekonomike si vijon: Për paga dhe mëditje për 964 të punësuar në Administratën Komunale, Arsim dhe Shëndetësi, buxheti i komunës është në shumë prej: 6,155,552.00€; Për mallra dhe shërbime, buxheti i komunës është në shumë prej: 2,432,982.00€; Për shpenzime komunali, buxheti i komunës është në shumë prej: 260,000.00€; Për subvencione e transfere, buxheti i komunës është në shumë prej: 960,402.00€; Për shpenzime në projekte kapitale, buxheti i komunës është në shumë prej: 5,285,000.00€. Vlerësimet e hershme të caktuara me kufijtë për Buxhetin e Planifikuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin fiskal 2024, është në shumë të përgjithshme prej: 16,055,499.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 5,593,999.00€ dhe për vitin fiskal 2025, është në shumë të përgjithshme prej: 16,669,974.00€, me shumën e caktuar për projekte kapitale prej: 5,820,321.00€.
2. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 890, të datës 09.09.2022 për bartjen e mjeteve financiare prej 690,000.00€ nga kategoria ekonomike e rezervës për vitin 2022 në projektet kapitale
3. Vendim për aprovimin e Raportit Financiar për buxhetin e shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës, për periudhën janar-qershor të vitit të 2022, në shumë të përgjithshme prej 3,811,977.24€.
4. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 331, të datës 14.09.2022, për fillimin e procedurës për hapjen e konkursit publikë për projektimin Arkitektonikë dhe Urbanistikë, të Bulevardit në rrugën e 'Dardanisë' në Fushë-Kosovë. Zona e projektuar në rrugën e 'Dardanisë' në Fushë-Kosovë duhet të përfshinë: pjesët rekreative duke rregulluar funksionalitetin e zonës me hapësira publike, sheshë, gjelbërim, mobileri urbane të rregulluar dhe funksionim efektivë të transportit dhe mobilitet të rrugës në gjatësi prej 800 metra. Kuvendi i Komunës e delegon autoritetin e tij tek Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, për shpalljen e procedurës së Prokurimit Publik, për ofrimin e zgjidhjeve urbane dhe projektit ideorë, që duhet të ofrohet nga Kompanitë projektuese në fushën e urbanistikës, përzgjedhjen e tyre nga një Komision me obligimin e zbatimit të projektit Arkitektonik dhe Urbanistikë në të gjitha fazat e zbatimit të tij.

5. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 332, të datës 14.09.2022, për fillimin e procedurës për hapjen e konkursit publikë për projektimin Arkitektonikë, për ndërtimin e Qendrës Multi-funksionale tek objekti i Shtëpisë së Kulturës me objektet tjera përcjellëse në Fushë-Kosovë, sipas Hartës Zonale të Komunës blloku Nr. 145 dhe lokacioni është i destinuar për Shtëpi të Kulturës dhe Statcion të Policisë, si zonë e shërbimeve. Zona e projektuar për ndërtimin e Qendrës Multi-funksionale tek objekti i Shtëpisë së Kulturës me objektet tjera përcjellëse në rrugën ‘Nëna Terezë’ në Fushë-Kosovë, duhet të përfshinë: objekte për aktivitete kulturore, kinema, teatër, hapësira për inovacion për rininë e komunës, për klube sportive, shoqata të ndryshme dhe subjekte politive. Kuvendi i Komunës e delegon autoritetin e tij tek Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, për shpalljen e procedurës së Prokurimit Publik, për ofrimin e zgjidhjeve urbane dhe projektit ideorë, që duhet të ofrohet nga Kompanitë projektuese në fushën e urbanistikës, përzgjedhjen nga një Komision me obligimin e zbatimit të projektit Arkitektonik në të gjitha fazat e zbatimit të tij.
6. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 333, të datës 14.09.2022, për hapjen e mundësive të reja për fillimin e procedurës për ndërtimin e lagjeve të reja me infrastrukturë moderne përmes përgatitjes së dokumentacionit hapësinorë për projekte konceptuale të natyrës së lagjeve urbane, me projektimin e zhvillimit të ri urban në zona të caktuara në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Projektimi i lagjeve të reja ndërlidhë konceptin dhe zbatimin e zhvillimeve të reja urbane, sipas projekteve konceptuale për zhvillim në zona të caktuara për lagje të reja, të projektura për zhvillimin ekonomik lokal, planifikimin urban e rural, strukturimin dhe ndërtimin e objekteve arsimore, shëndetësore dhe rekreativo-sportive në zonën e projektuar. Kuvendi i Komunës e delegon autoritetin e tij tek Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, për hapjen e mundësive për ndërtimin e lagjeve të reja në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, sipas projekteve konceptuale që ofrohen nga Kompanitë ndërtimore projektuese në fushën e urbanistikës dhe investitorët e mundshëm për zhvillimin e ri urban.
7. Për aprovimin e Propozimit Nr. 334, të datës 14.09.2022, për realizimin e projektit ‘Drejtësia Sociale I’, përmes një projekti pilotim për ‘Transformimin e vendbanimeve’ në lagjen 028, 029 dhe zonat për rreth në pjesë të ndryshme të Fushë-Kosovës, për zgjidhjen e banimit të qëndrueshëm. Projektimi i lagjeve 028, 029 dhe zonave për rreth, realizohet përmes hapjes së procedurave për arritjen e ‘Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Komunës së Fushë-Kosovës dhe organizatës Voice of Roma Ashkali e Egyptians’, sipas projekteve konceptuale për zgjidhjen e banimit të qëndrueshëm. Kuvendi i Komunës e delegon autoritetin e tij tek Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Planifikimit Urban, për hapjen e mundësive për ndërtimin e shtëpive në vargë dhe krijimin e strukturës së re të ndërtimeve në lagjen 028 dhe 029, sipas projekteve konceptuale për këto shtëpi në fushën e urbanistikës me këtë organizatë Voice of Roma Ashkali e Egyptians, me integrim të këtyre zonave në planet zhvillimore dhe urbane në kuadër të Hartës Zonale të Komunës, me lejimin e ndërtimeve të ulëta në zonën e caktuar.
8. Vendim për aprovimin në parim të Propozimit Nr. 908, të datës 14.09.2022, për ndryshimplotësimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë me Nr. 140, të datës 29.09.2017 dhe dërgimin e tij në procedurën e diskutimit publik, me përfshirjen e mjekut pediatër dhe gjinekolog në statut.

9. Vendim për miratimin e Rregullores Komunale për bonuse të zonimit në Komunën e Fushë-Kosovës. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja Komunale për bonuset e zonimit për ndërtime në Komunën e Fushë-Kosovës.
10. Vendim për miratimin e Rregullores për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridikë në Komunën e Fushë-Kosovës. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridikë në Komunën e Fushë-Kosovës.
11. Vendim për lejimin e vizitës zyrtare në Republikën e Shqipërisë në muajin tetor 2022, e lidhur me ftesën e Bashkisë së Shkodrës - Këshillit Bashkiak të Shkodrës. Organizimi i vizitës zyrtare bëhet nga data: 20-22.10.2022, sipas shkresës zyrtare të Këshillit Bashkiak të Shkodrës Nr. 15298, të datës 13.10.2022.

Nëntor 2022

1. Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronës shoqërore P.sh. KBI Kosova Export N.sh. Bujqësia, të menaxhuar nga Agjensia Kosovare e Privatizimit, e evidentuar në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514036-00776-34, në sipërfaqe prej S=18871 m², në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, për ndërtimin e Stadiumit të Qytetit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë.
2. Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave shoqërore P.sh. KBI Kosova Export N.sh. Bujqësia, të menaxhuara nga Agjensia Kosovare e Privatizimit, të evidentuara në Ngastrat Kadastrale në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, në afërsi të Stadiumit të Qytetit 'Ekrem Grajçevci' në Fushë-Kosovë, për shërbime të sportit, si vijon:
 - 1.1 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00772-3, në sipërfaqe prej S=1242 m²;
 - 1.2 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00772-6, në sipërfaqe prej S=307 m²;
 - 1.3 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00769-5, në sipërfaqe prej S=761 m²;
 - 1.4 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00773-3, në sipërfaqe prej S=1144m².
3. Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave shoqërore P.sh. KBI Kosova Export N.sh. Bujqësia, të menaxhuara nga Agjensia Kosovare e Privatizimit, të evidentuara në Ngastrat Kadastrale të identifikuara për zgjerimin e varrezave në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë si vijon:
4. Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave shoqërore P.sh. KBI Kosova Export N.sh. Bujqësia, të menaxhuara nga Agjensia Kosovare e Privatizimit, të evidentuara në Ngastrat Kadastrale në Fushë-Kosovë, të identifikuara tek lagjia 300, ku është e ndërtuar Shkolla, Qendra e Mjekësisë Familjare si dhe banesat kolektive - Kompleksi 300 si vijon:
5. Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave shoqërore P.sh. KBI Kosova Export N.sh. Bujqësia, të menaxhuara nga Agjensia Kosovare e Privatizimit, të evidentuara në Ngastrat Kadastrale në Fushë-Kosovë, prapa komunës ku nodhet tregu si vijon:
6. Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave shoqërore P.sh. KBI Kosova Export N.sh. Bujqësia, të menaxhuara nga Agjensia Kosovare e Privatizimit, të evidentuara në Ngastrat Kadastrale në Zonën Kadastrale Bardh i Madh te shkolla dhe Stadiumi i fshatit Bardh i Madh si vijon:

7. Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të pronave shoqërore P.sh. KBI Kosova Export N.sh. Bujqësia, të menaxhuara nga Agjensia Kosovare e Privatizimit, të evidentuara në Ngastrat Kadastrale në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe dhe Miradi e Epërme për ndërtimin e objekteve të kulturës si vijon:
8. Vendim për ndryshim - plotësimin e vendimit Nr. 204, të datës 04.10.2022 dhe propozimin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 890, të datës 09.09.2022, për transfer të mjeteve nga kategoria e rezervës në kategorinë e shpenzimeve kapitale për vitin 2022 në shumë të përgjithshme të mjeteve financiare prej: 690,000.00€, të shpërndahen nëpër projekte kapitale.
9. Vendimi për përcaktimin e kompenzimit të anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', të caktuar sipas vendimit të Kuvendit të Komunës, për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve Nr. 171, të datës 05.07.2022
10. Vendimi për formimin e Grupit Punues për Hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, në përbërje prej: njëmbëdhjetë (11) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës;
 - 1.2 Fadil Krasniqi - Përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar Ligjor për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.4 Remzi Shala - përfaqësues nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.5 Durim Hajra - përfaqësues nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.6 Aida Alimi - përfaqësuese nga Partia Demokratike e Kosovës, anëtare;
 - 1.7 Arbnora Asllani Kelmendi - përfaqësues nga Nisma Socialdemokrate, anëtar;
 - 1.8 Hasan Ismajli - përfaqësues nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
 - 1.9 Qëndresa Ademi - përfaqësues nga Iniciativa e Fushë-Kosovës e Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve, anëtar;
 - 1.10 Artan Asllani - përfaqësues nga Lista Ndryshe, anëtar;
 - 1.10 Radoman Doderovic - përfaqësues nga Iniciativa Qytetare Serbe, anëtar.
11. Vendimi për ndryshim-plotësimin e paragrafit 1, nënparagrafi 1.2 të vendimit Nr. 53, të datës 07.03.2022, për zëvendësimin e përfaqësuesit të Nismës Socialdemokrate në përbërjen e Komitetit për Persona me Nevoja të Veçanta,
12. Vendimi për shfuqizimin e vendimit Nr. 188, të datës 04.08.2022, për lejimin e mjeteve financiare për Klubin e Vollejboillit për Femra 'Fushë-Kosova'.
13. Vendimi për miratimin e Propozimit Nr. 372, të datës 26.10.2022 për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2023 si vijon:
 - 1.1 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.50€ për një metër katror në kategorinë e parë;
 - 1.2 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.65€ për një metër katror në kategorinë e dytë;
 - 1.3 Taksa administrative për leje të rrënit në shumë prej 0.80€ për një metër katror;
 - 1.4 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë në shumë prej 5.72€ për një metër katror.

Dhjetor 2022

1. Vendimi për aprovimin e Propozimit Nr. 1136, të datës 21.11.2022, për fillimin e procedurave për lejimin e ndërtimit të dy objekteve shkollore në Fushë-Kosovë me kompensim në ndërtim, përmes bonuseve të ndërtimit konform planeve hapësinore në fuqi me marrëveshje, ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës me Kompanitë ndërtimore 'Mendi' sh.p.k, 'A&A Group' sh.p.k dhe 'BNT', sh.p.k, për pronat e identifikuara në ngastrat kadastrale si vijon:
 - 1.1 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00410-38, me sipërfaqe S=1343m² dhe një pjesë e ngastrës kadastrale Nr. P-72514036-02799-0, me sipërfaqe S=500m²;
 - 1.2 Ngastra Kadastrale Nr. P-72514036-00417-6 dhe ngastra kadastrale Nr. P-72514036-00416-5 me sipërfaqe S=2000m².
2. Vendimi për aprovimin e Propozimit Nr. 1140, të datës 22.11.2022, për lejimin e mjeteve financiare për marrjen me qira të pronës së Hekurudhave të Kosovës, nga ndërmarrja publike 'Infrakos'. SH.A, për periudhën tre vjeçare, me një kosto financiare vjetore prej: 6.012.96€, për sipërfaqen e nevojshme prej: S=2238m² për 'Rikonstruimin e rrugës Miradi - Zona Industriale', projekt i financiar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.
3. Vendimi për aprovimin në parim për diskutim publikë të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023.
4. Vendim për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Organizimin e punës në 'Shkollat Filllore të Mesme të Ulët dhe Shkollat e Mesme të Larta të Komunës së Fushë-Kosovës'.
5. Vendim për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës.
6. Vendim për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në Komunën e Fushë-Kosovës.
7. Vendim për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës me dokumentacion personal të identifikimit, për periudhën janar-mars të vitit 2023, me mundësi vazhdimi edhe për tre muaj, në shumë të mjeteve financiare prej 245.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
8. Vendim për aprovimin e Propozimit Nr. 1255, të datës 13.12.2022 për fillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim me qira të objekteve të Ambulancave të Mjekësisë Familjare për periudhën njëvjeçare në fshatrat si vijon:
9. Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr.210 të datës 05.10.2022 dhe rregullores Nr. 211 të datës 05.10.2022 për bonuse të zoonimit, sipas shkresës me Nr. 5996-2/22, të datës 25.10.2022, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe shkresës Nr. 0-910/2, të datës 25.10.2022, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
10. Vendim për miratimin e Rregullores Komunale për bonuse të zonimit në Komunën e Fushë-Kosovës.

Lista e rregulloreve komunale

1.1 Ndryshim-Plotësimi i Rregullores për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale Nr.152, të datës 06.06.2022.

1.2 Rregullore Komunale për bonuse të zonimit. **(E kthyer në rishqyrtim)**

1.3 Rregullore për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridikë në Komunën e Fushë-Kosovës. **(E kthyer në rishqyrtim)**

1.4 Rregullore Komunale për bonuse të zonimit. **(E rishqyrtuar dhe ndryshura)**

Konkluzionet dhe rekomandimet

Kuvendi i Komunës ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje, prej tyre 11 të rregullta dhe mbledhjen jashtëzakonshme ka marrë gjithsej 85 vendime, si vendime të kundërligjshme për rishqyrtim, ndryshim-plotësim apo shfuqizim janë trajtuar në mbledhje të Kuvendit gjithsej 17 vendime, prej tyre janë shfuqizuar 5 vendime, ndërsa 9 vendime të tjera kanë mbetur në fuqi pas votimit në Kuvendin e Komunës dhe tre janë ndryshuar dhe plotësuar pas rishqyrtimit. Arsyeja për kthyerjen në rishqyrtim të këtyre vendimeve, kryesisht nga MMPHI dhe MFT, janë synimet dhe programi i Ekzekutivit të Komunës, për zhvillimin ekonomik lokal dhe vendimeve me karakter strategjikë, urbanistikë dhe zhvillimor, të cilat kërkohet të vendosen në harmoni me hartën Zonale të Komunës, e cila paraqet një pengesë në këto programe, sepse kjo hartë mund të ndryshohet vetëm sipas rregullave pas katër viteve dhe aty nuk janë përfshirë këto projekte për zhvillim. Rëndësi e vecantë është edhe marrja e shtatë vendimeve për interesin e vecantë publikë, për ndërtimin e stadiumit të qytetit, shkollave, ambulantave dhe objekteve sportive, pastaj zgjerimin e varrezave në qytet

Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, për të gjitha pikat e rendit të ditës që janë shqyrtuar ka patur debate të hapura dhe përmbajtjesore para marrjes së vendimeve. Vendimet e marra nga Kuvendi i Komunës dhe ekstraktet e procesverbaleve janë të publikuara në ueb-faqe. Lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë dhënë përgjigje gojore për një pjesë të tyre nga Drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe Nënkrjetari i Komunës. Sfidat e Kuvendit mbeten, publikimi i audioincizimeve që duhet të realizohet nga Ekzekutivi i Komunës, hartimi dhe miratimi i gjashtë rregulloreve të mbetura dhe kodit të etikës nga viti 2022, ku vlen të theksohet se nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, është ftuar secili Grup Punues, ky është caktuar Kryesuesi i Grupit, pastaj ka patur ngecje në realizimin e detyrave të punës.

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

